

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8SH-1  
B 37

Sadik Bejko

KU E KA  
FOLENE  
BILBILI

poezi

891.985-1

814-1

337

Sadik Bejko

11554

KU E KA  
FOLENE  
BILBILI

poezi

80282

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

1

20

2

## *E shtunë, mesnatë*

E qeshura ngroh buzët tona të çelura,  
ashtu si ngrohtësia e klimës në maj,  
që rrit trëndafilat dhe humorin e mirë  
e njeriu me të tjerët do t'i ndajë.

Është e shtunë, mesnatë, jemi nën tokë.  
«Ç'të kenë», thotë me vete brigadieri,  
e qeshura e së shtunës bie mbi veshje grash,  
mbi aroma flokësh, mbi ngjyra ylberi.

Si kontrasti i fortë i ekranit televiziv,  
është figura jonë me qymyr ngarkuar,  
ne, arkitrarët, gjithmonë të fuqishëm,  
ku jeta ngrihet, hedh vallen e gëzuar.

Puna e ngroh të qeshurën mbi buzët tonë,  
të qeshurën e ndezur mbi natën dhe shkëmbinjtë;  
ajo del që nga këto galeri të lagështa  
shkon tek sallat tonë me muzikë e dritë.

## *Pesha e nëntokës*

Çdo ditë marr baltën për minat,  
tek eci nën shkëmbin e natën e nëntokës,  
mendoj se çdo njeri, me mënyrën e tij,  
sipas gjithë rrugëve është i lidhur me tokën.

Ja, kjo baltë me rrënje lulesh,  
me rrënje të forta lisash mali,  
është dora që më zgjatet nga toka  
te kjo natë shkëmbi e minerali.

Njeriun vetëm toka s'e bëka të lumtur,  
ndaj sulet në qiejt, akujt, detet e stuhihëm;  
po në trastën e tij buka, frutat apo uji  
i zgjaten nga toka si litarë të pazgjidhshëm.

Nën tokë, shkëmbit që të zë rrugën  
kjo baltë përmbi minat i vë supet,  
gëzimi njerëzor kështu bëhet më i madh:  
mbi natën e shkëmbin fitojnë lulet.

Marr baltën në trastë tek hyj në minierë,  
ndiej se lidhem padukshëm me shumë shokë,  
secili nga ne mban pak dhe mbi supe,  
të gjithë bashkë mbajmë krejt këtë tokë.

## *Letër*

Në fytyrë kam qymyr të vijëzuar nga djersa,  
në sy borën e malit të bukur ballë meje,  
në duar dy lule bajameje,  
nën këmbë është balta e arave  
e thellë në zemër shqetësimi e malli i bardhë  
për ty që më je larg  
e plot ankthe pér lindjen e parë.

Prap' yni është ky mëngjes shkurti,  
lulet, thëllimi i tij,  
dashuria e përpjekja janë tonat.  
Ndaj zemër, zemër të fortë, mikja ime,  
se qymyri shndërrrohet në zjarr,  
bora e malit në ujë  
pér banjën e ngrohtë të atij që presim,

lulet do tē lidhin fruta pēr tē,  
balta do t'i japē kallinj,  
pastaj ... ai do pērralla,  
lodra e libra tē rinj...

Së fundi, vë nē këtë letër  
këto dy lule bajameje;  
është dashuria ime pēr ty,  
shembëllimi njerëzor i bashkimit tē dy duarve.

## *Yjet e nëntokës*

Tek dalin minatorët nga galeritë e mëngjeseve,  
thua këto llamba u shtohen yjeve,  
i shtohen vetë dritës së diellit.

Puna i ndriçon nga brenda si llamba thellësitë,  
nxjerrin nga miliarda tonë shkëmb,  
një grusht mineral si zjarr me dritë.

Na duhet secilit kjo llambë — yll në ballë,  
të zhytemi thellë në të vërtetat e punës,  
të gjejmë çka është mineral i rrallë.

Me punën tonë të çelim nga një yll  
që mund t'u shtohet vezullimeve të qiellit,  
si këta pishtarë që u shtohet nga nëntoka  
dritave të mëngjesit.

## *Qielli dhe qyteti*

Punojmë natën në mjedise guri  
dhe minerali me peshë të pamatë,  
mendimi ynë shkon tek ata që flenë,  
me ne janë ata tek çajmë këtë natë.

Ne që punojmë ndritim si yjet në qiell,  
ku tek e tuk e ku me trumba,  
mes nesh është një hapësirë e butë  
si xham që e ka veshur fryma.

Është fryma e ngrohtë e atyre që flenë,  
që na rrethon tek punojmë këtë natë,  
se njerëzit përmes punës takohen  
edhe kur flenë e s'janë bashkë.

Asgjë nuk ndajnë netët, largësitë,  
ky bashkim është i madh, i plotë,  
qielli — si një mijë qytete me drita,  
të pagjumët — yje mes natës së ngrohtë.

## *Trimëri e re*

Qymyr, o diell i zi, i lashtë,  
që kohëve të reja u jep ngrohtësinë,  
ndoshta toka të hëngri nga uria,  
ndoshta nga të ftohtët ajo hapi gjinë.

Ti je më i lashtë nga njeriu,  
po vendit tim, që për trimëri shkëlqeu,  
iu desh një trimëri e re  
që ty të të nxirrte nga dheu.

Iu desh partizanit të bëhej minator,  
u desh të përbysen shumë idhuj e perëndi,  
ndoshta ata të mbanin të kyçur  
më fort se sa nofullat-shkëmbinj.

Qymyr, o diell i zi, i lashtë,  
që kohëve të reja u jep ngrohtësinë  
në një trimëri të re, të përditshme,  
e thërret njerinë.

## Zogjtë

Si në fëmijni s'dashurohem më zogjtë,  
por dhe përgjithmonë s'i përzura ata;  
shkoj dhe vij nga puna natën, ditën,  
këngë si diell, si vesë më ra.

Rrugës së minierës dëgjoj shtegtarët,  
zogjtë e ngrohtësisë e të këngës,  
i shoh nga dritarja e makinës,  
fletëpruaruarit prej diellit dhe hënës.

S'kam dashuri të veçantë për zogjtë,  
por këngët më joshin vetvetiu,  
sa edhe mikes i flas «zoçkë»  
dhe djalit — zogu ciu-ciu.

Mua zogjtë s'më kthejnë nga rruga,  
ndaj dhe kurrë s'i përzura ata,  
shkoj dhe vij nga puna natën, ditën,  
kënga si diell, si vesë më ra.

## *Minatori dhe dielli*

Diellit ai mund t'i thotë:  
mirëmëngjes, o shok, —  
të dy punojnë me tri turne,  
ndoshta në punën më të fortë.

Vijnë si dy miq drejt njëri-tjetrit,  
duke i sjellë shokut gjithë ngrohtësinë;  
që të ketë dritë e mëngjes,  
njëri ka çarë qiellin tjetri thellësinë.

Dielli i madh nga retë,  
duke rrokur çdo fletë e hije,  
rrok në krahët e tij minatorin,  
bashkë përqafohen dhe shkrihen.

## *Zbritje në thellësi*

Ashensor. Mugëtirë dhe erë.  
Vesë ujërash e hollë e hollë...  
Sikur jemi lëshuar thellë e më thellë,  
një fill na mban mbi këtë hon;  
fill i lidhur te duart e shokëve,  
i lidhur te duart e grave  
dhe të fëmijëve tanë të mitur.  
Të kapur pas këtij filli  
zemrën e kemi të ngrohtë  
dhe në fund të botës të kemi zbritur.

E kështu tejpërtej të përshkuar  
nga fije të ngrohta dashurie  
për një grua, për një foshnjë, për një njeri të mirë,

çojmë jetë atje ku ka heshtur jeta,  
çojmë dritë tek më e plota errësirë.  
S'ndalemi t'i sjellim socializmit dritë  
dhe nga më e pafundmja thellësi.

## *Dallëndyshet e minierës*

Tendosur i téri në shtytje të një vagoni,  
mes dy shinash vagonisti i minierës,  
aq i tendosur sikur matet të fluturojë,  
të ngrihet në qìell si zogjtë krahënderë.

Të kujton dallëndyshet në mars,  
kur sjellin ndër krahë erën e pranverës,  
kur sjellin vetë diellin në sqepin e artë,  
ky vagonist, dallëndyshe e minierës.

Shtyn vagonin me prush të kuq një ton,  
çon në shtëpitë tona zjarr të nevojshëm sa mielli,  
çon zjarr në kaldaja, shkolla e TEC-e,  
zjarr që s'e zëvendëson dot dielli.

Eshtë shtegtar fisnik i zjarrit,  
kur zogjtë ikin, kur në qiel venitet dielli,  
ai zog i përhershëm i ngrohtësisë  
pranverë shkëput nga toka së thelli.

## *Njeriu i punës*

Më flet... qetohem e kthjellohem,  
ndiej si shkrihen realiteti dhe ëndrra;  
ai — toka e ngrohtë e ardhur mirë  
me farën brenda.

## *Zërat e thellë*

Eci pas gjurmëve të minatorëve nën tokë,  
pas vëllezërve të mi ish-fshatarë,  
jam plotësisht në vazhdën e gjakut tim,  
që më erdhi i rrëmbyer në damarë.

Brenda meje ka qenë një njeri i rreptë,  
ai thoshte: «Lëri librat, te ne kthehu!»;  
atë s'e fshehin dot vjershat që shkruaj,  
studimet dhe nëpunësia s'e fshehu.

Pa më lindur, e ëndërronte nëna ime  
atë burrë të punëve të forta e me rrezik,  
ai ngjan me barinjtë e druvarët e pyjeve,  
me këta minatorë, shokë dhe miq.

Ai më flet nga adoleshenca ime,  
kur isha bari i vogël kokëqethur;  
ty të presin arat djerrë, ai thotë,  
ty të pret minerali i fshehur.

Librat, domosdo, duhen, thotë, po më mirë se bojë,  
eja të derdhësh mbi tokë djersë e jetë;  
kthehu, rrökemi, erdhe përgjithmonë,  
kjo është bota jote e fortë, e vërtetë.

Nuk janë vetëm zëra të gjakut,  
po dhe një zë tjetër si dheu e deti thërret:  
pa këta njerëz nuk derdhet në libra  
ai gjaku i rrëmbyer, plot jetë.

## *Gjithmonë e bukur*

Gjithmonë e bukur toka,  
nëna e njeriut,  
ky qymyr në shekuj këtu  
bënte gjumin e ariut.

Gurët e vegjël këputur nga minat  
janë shpend të egër  
në fluturim të verbër.

Billojet shkëmbore-arinj prehistorikë  
zënë çdo kthesë, çdo hyrje,  
po unë shkoj duke i mundur shpendët  
dhe gurët-arinj në strofkën e tyre.

Kjo s'është as e lehtë, as përrallë...  
Unë kam një pistoletë elektrike  
dhe një llambë elektroliti në ballë.

Kjo është bukuri e vështirë,  
minatorët janë njerëz  
që kërkojnë diellin  
në më të plotën errësirë.

Gjithmonë më e bukur toka, nëna jonë,  
të pafund i ka thesaret, ngrohtësinë:  
ky qymyr-rezervuar dielli,  
në gji të saj u ruajt për njerinë.

## *Mirëmbeç, bilbil*

Secili nga ne është në vendin e tij:  
ti je i ajrit të butë, i ajrit të vakët,  
unë bëj jetën e njeriut në diell e ngricë,  
nën tokë ku s'rreh dot asnjë flatër.

Ti në gjeth, unë gjurmoj thellësinë,  
unë kam një llambë — ti spektrat diellorë....  
Mirëmbeç, i them këngës sate të vogël,  
më presin gjëmime minash dhe motorë.

Unë për ty, për pak tinguj i vidhem gjumit,  
kënga sikur vjen nga plasat e dheut,  
nga zemra e drurëve,  
thellë nga ujërat e lumit.

Vjen ajo përditë në orën katër  
e kështu do të doja të vinte  
në gjithë mëngjeset e mia...  
Mirëmbeg, bilbil, ti këndon bukur,  
por njeriut i duhet kërkimi, thellësia.

МУЖИЩА СТРАННО БЫ БЫСТРО

## *Revolucioni*

Nën blerimin e grurit të ri në majë,  
nën bakrin e telave të rinj elektrikë  
flenë tragjeditë e vjetra të popullit:  
zia, pushtimet, epidemitë.

Nën rrugët e hekurta të kohëve tona,  
nën themele uzinash e nën furnalta,  
shtypet myku e ndryshku i vjetërsisë,  
gjarpërinj idesh «të reja» shtypen ndër baltra.

Revolucioni shëroi plagët e tokës,  
mendimet tona bëri më të urta,  
në shërbim të tij shekujt shqiptarë  
radhitur si ushtarë të kalitur ndër luftëra.

## *Ditët me emra të bukur*

O ditë me emra të bukur,  
me emra heronjsh të luftës e të punës,  
ditë me emrin e Partisë,  
ditë komuniste,  
ju u shkruat mbi natën  
me shifra të pashuara drite.

Ditë — shekuj përnjë popull me halle,  
ditë që u zmadhuat e morët  
përmasa dielli,  
në zmadhimin tuaj është emri ynë  
që sulmoi i pafrikshëm perënditë  
dhe i zboi zhelet nga tokë e qelli.

Nën këtë qelli të pastër nga retë  
e bëmë këtë tokë pjellore e bujare,

i dhamë ngrohtësinë e pafund të amësisë,  
e lartuam të bukuritë më të gjera  
e ajo lindi tashmë gjithë dritat,  
bukën e zjarrin që dikur i fshihtë  
bashkë me shkëmbinjtë në legjendat.

Ditë me emra të bukur,  
me emra heronjsh,  
ditë komuniste,  
ju i zgjeroni hapësirat tonë të kthellta  
me shpërthime grunjash e shatërvanë drite.

## *Trok itje*

Sot më zgjoi nga gjumi një tuk-tuk,  
si trokitja e zogut në lëvoren e bardhë të vezës.  
Zgjimi — një lartësim në majëmalet e botës,  
zgjimi — syri që hapet para dritave e lëvizjeve të  
jetës.

Një sqep i verdhë trokiti në kokën time gjumin  
dhe ai u tret i padukshëm nëpër agun vetëtitës.  
Ndjeva tiktakun ritmik të orës,  
pashë dritaren e hapur drejt dritës.

Pashë malin që u përkul nga trokitja e rrezes,  
rrugën që një hap e zgjoi prej heshtjes,  
dhe një syth pemës i dha dridhmat e gjethes...

Tuk-tuk,... dhe është kaq e fortë jeta  
kur dita lan natën në sytë e përgjumur të tokës,  
kur trokasin asfaltin hapat si pëllumbat mbi çati,  
kur trokasin natën punëtorët  
me drita e bori.

Atëherë trokit, trokit, o sqep në lëvoren e vezës,  
jepu dritën zogjve të jetës.

## *Komunisti shqiptar*

Në ballin tënd është ajo pjerrësia e zhveshur  
me brëza rrudhash e malevë tonë,  
ku shkrepën vitet me rrufe të historisë  
ndër shekuj e gjer në ditët më të vona.

Fytyra e hequr ka diçka nga shpatet malore  
e ngë tokë jonë për drithë etur,  
në shtatin tënd hijeshon  
përhedhja e fortë e bredhave të vjetër.

E te sytë e tu është një dritë e qartë  
që tejshkon të djeshmen e të ardhmen e historisë,  
thinjat janë avujt e bardhë të hidrocentraleve,  
avujt e metaleve të metalurgjisë.

Në ballin tënd është ajo pjerrësia e blertë  
me brezare në rrudhat e maleve tonë,  
me zemrën tënde diell ngroh këto ditë  
që në vrap të historisë s'do t'u shuhet jehona.

## *Gjaku dhe nafta*

Turbull, turbull naftë e gjak valon kazani,  
yshtur në Moskë nga kryemagjistica,  
në ata avuj mbytet fund e majë Afgani,  
mbi lule ata avuj kthehen gjak e ngrica.

Makbeth Karmali me shpirtin plot akrepa,  
fërkon duart e mardhura nga ethet e pushtetit,  
tanket kafshojnë shkretëtira e stepa,  
qilima gjak e koska i shtrojnë Makbethit.

Se zbardh e zeza, e bardha nxin si natë,  
thërrasin bujarë e gjeneralë në bankete,  
një krim kurtizanin e kthen në fantazmë,  
me një krim nis rruga për gradë e privilegje.

Shkoi një dimër dhe një verë,  
ja, rrëth magjisë sterrë,  
Brezhnjevë e Karmalë dridhen, ndiejnë fundin:  
tokë e Afganit çahet, hapet humnerë,  
korbat mbi kufoma kthetrat do t'u ngulin.

## *Mikroborgjezes*

Grua, që të del gjumi në orën tre,  
je ende e re, vuan pak nga tensioni,  
por kjo s'është gjë: ke dy fëmijë dembelë,  
për «hallet» e tyre çdo natë mendoni.

S'dua që të fyej ndonjë nënë në botë,  
grua, që çdo natë merr valium,  
për ty mendoj me një dhembje të fortë,  
kur nga shqetësimi s'të vjen pikë gjumë.

Po ti s'mund të jesh nënë e mirë,  
kur rrite dy të përkëdhelur e asgjë tjetër,  
kur romantizmin e rinisë nga vetja ke fshirë,  
si ndryshku numrat e pares së vjetër.

Ti doje që ata kurrë tē mos lodheshin,  
që ata tē hanin e tē flinin sa më shumë,  
ti duke i shtrënguar fort pás vetes i mbyte,  
i mbyti malli yt i sëmurë.

Ja, këtë askush s'ta fal kurrë,  
që rrite dy dembelë éshtë faj, éshtë krim,  
grua e shqetësuar që s'fle dot gjumë,  
që ta largon gjumin i rrëpti mendim.

## *Mbi fletoret e hartimeve*

*(Nxënësve të mi të Hlomosë)*

Korrigjoj gabime të njohura  
kërrusur mbi fletoren e hartimit,  
pronorët e vështirë për Vllahon,  
nyyat e përparme të Filipit.

Mes shkrimit të kërleshur të Fanit  
ëndem si nëpër një xhungël,  
me vizat e kuqe të vetëtimta  
i tregoj rrugën e humbur.

Joti që i do shumë bagëtitë  
shkruan fjalë të palidhura si blegërima,  
pena ime si kërraba e bariut  
gabimeve u vë gardhe e trina.

Tek bëj këtë punë kaq të vjetër,  
nuk mbart shkëmbinjtë e Sizifit,  
pika ime e djersës mbi letër  
bie pranë notës së hartimit..

Atëherë ndiej se e kam ngrohur  
këtë letër radhë më radhë  
dhe herë tjetër nota do të çelë  
në fytyrat si lule e bardhë.

## *Për vete*

Kam ardhur në jetë si 'gëzim i shumëpritur,  
s'u therën dema brikurorë e deshë të bardhë,  
njerëz me shpatulla të djersitura  
e ftyra të gëzuara  
kënduan e uruan disa ditë me radhë.

Kam ardhur te njerëz të thjeshtë  
isha «kapitali» i vyer i të mirit baba  
dhe stolia më e bukur e nënës sime  
që ende e parritur u bë mama.

Kam ardhur në jetë  
te gëzimi dhe puna e dheut që më lindi;  
të ishtejeta ime pasuri dhe stoli e tij,  
siç qe, sigurisht, lindja ime për prindërit.

## *Tokëzë e bukurzë*

Tokëzë e bukurzë!

Mërmërimë që i shtohet natës së prillit,  
dridhjes së gjethishtes,  
cicërimave të bilbilit.

Ajër dehës i lehtë,

ke ngjyrën e natës  
tokëzë e bukurzë, e afërt.

Ti s'e duron përgjithmonë,  
dimrin e zhveshur të errët.

Ti e lan fytyrën tënde  
në gjelbërim të freskët.

Tokëzë e bukurzë,  
ç'kam një dëshirë të fle diku lart,  
në rrymat e flladeve  
ngjyrosur nga kjo natë.

Në rrymat që enden  
nga njëri në tjetrin breg  
të fle si zogjtë  
i mbështjellë në gjethin  
e njomë, të blertë.

## *Shtatë burimet e korijeve*

Ju rridhni, freski e kthjellësi e tokës,  
rritët njerëzit e zakonshëm e ata që hyjnë në histori,  
ju penj të gjallë e të fortë nga e jonë thellësi.

Rrjedh ti, Gurraz, zallor i bardhë, i bardhë...  
Zbardhin dhe lëveret që lajmë të dielave,  
lulet e kopshteve e tufat e deleve...

Rrjedh fshehur në lajthishte ti, ujë i Dafinës;  
në shtrat të vdekjes pleqtë e katundit  
pinë ujin tënd, pastaj dhanë fryshtë e fundit.

Çurkëz mes Korijes së Madhe,  
ti rrjedh më ëmbël, apo filli i mjaltit të artë  
që verës shkrin e varet nga lisat e gjatë?

Uji i arës me emrin Sheshi i Bukur,  
zinxhir i hollë argjendi në lug druri lëvare,  
melodioz si këngë nga fyej prej panje.

Te Shkozë e Lumanit, Luadheve me përrenj të tharë,  
rrjedh ujë nën shkurrnjë e lisa të dendur,  
ujë që kurrë dielli s'e ka parë.

Burimi i Gjoleve çel mes arave të bukës,  
ara të plasaritura, gojëhapura,  
nën flakët e diellit, si në gojën e furrës.

Rrohdhët e njomët fëmijërinë time,  
te këto vise që më dhanë hapin e burrit,  
vise ku më sillnin bagëtia, buka e lënda e drurit.

Rridhni të qeta... akujt as vapa s'ju ndalën,  
rridhni dhe, kur në fshat çezma e puse shterren,  
sa shkon korriku që pëlçet në degë gjinkallën.

Fise kanë shkuar, breza lindën e u ndërruan  
po te ju, që rridhni ujë sa gishti i vogël i dorës,  
në gusht e vapë e shuan etjen.

Te kjo jetë e gjelbër që rritni, vij pi me etje  
e ju bart si gamilja në më të gjatin udhëtim,  
gurra të kthjellëta, shushuritëse e të pashterrim.

## *Të përjetshëm*

Mund të fluturojnë  
drejt lumenjve tanë,  
për t'u prerë në mes rrjedhat e bardha  
shpendët e hekurt e të mëdhenj  
të fuqive të huaja.

Mund të fluturojnë  
drejt maleve tonë,  
për t'u prerë rrugën zogjve në pranvera,  
në tela, gjethet e degëve e drurëve  
të lëshojnë predha.

Po telat në gryka e ndanë lumenjve  
janë të përjetshëm në pritjen e tyre për zogj,  
të përjetshëm janë drunjtë në male e fusha  
në pritjen për zogj dhe fruta.

Të përjetshëm jemi ne në atë pritjen  
për fëmijë të bukur, për qytete të rinj,  
e në atë gatishmërinë tonë të përhershme  
ndaj kujtdo që armët vringëllin.

## *D a s h u r i*

T'i prekësh me gishta të lehtë flokët,  
ndërsa fle, t'i prekësh fytyrën që zgjohet,  
si ai që sheh pjekjen e grurit të zverdhur,  
si ai që këput lulen  
i ngrohtë e dorëdredhur.

T'i mbash dorën mbi zemër,  
si mbi zemrën e jetës  
e të dëgjosh si vjen mëngjesi  
nëpër të rrähura të shëndosha, të forta,  
të ndiesh si zgjohen malet e lumenjtë,  
si marrin frymë fëmijët  
me faqet mbi lodra.

Të gjitha këto më thonë sejeta ka diçka  
nga bukuria më e brishtë e fluturave

e çelja e luleve,  
se ka diçka nga forca e diamantëve,  
që u qëndrojnë deformimeve, përkuljeve.

Të gjitha këto më thonë diçka  
për atë dashuri të gjerë, reale  
ku dy njerëz botën mund të fusin  
në atë shtrëngim intim të katër krahëve.

## *Pesëmbëdhjetë shkurt*

Kam një bir, kam një bir, pëshpërisja,  
ecja e u bija përmes pellgjeve,  
bajamja kishte çelur në lugina,  
ti kishe ardhur mes njerëzve.

Atë ditë e në çdo pesëmbëdhjetë shkurt,  
u bie përmes shirave me dëshirë,  
jo me pije e çokollata, me gëzimin tim  
mund të ëdeh e të ëmbëlsoj çdo  
njeri të mirë.

Eci dhe borën që bie mbi majë  
e shoh të shndërruar në lule bajamesh...  
Kam një bir, kam një bir e kjo do të thotë  
të ecësh, të ecësh e kurrë të mos ndalesh.

## *Mëngjes me dallgë*

Në rrugën e larë nga dallgët e fortë  
eci stërpikur në flokë e fytyrë,  
në trup më varën rrëke të fortë,  
eci buzë detit që pa gdhirë.

Në rrugën e larë nga dallgët  
veshët me gjëmime m'u mbushën, m'u zunë;  
lëvizjet e egra e të fortë dallgëve  
drithma jete lindin tek unë.

Në rrugën e larë nga dallgët,  
i njomur nga ujërat me stuhi,  
me një drithë që më mbush plot e përplot  
te vilat e bregut kthehen tani.

Vij i sterpikur në flokë e fytyrë,  
në trup më varen rrëke të ftohta,  
rrugën ma ndritën vetëtimat,  
mëngjesi çel dritare e porta.

## *Fshati Maricaj*

Fshati Maricaj, fshati i nënës sime,  
ia njoh shtëpitë katërqoshelie,  
dheu aty e bën bukën më të ëmbël,  
pemët janë më të buta, më me shije.

Pleqtë pa dhëmbë derdhën urime në veshin tim,  
kur isha në prehër të nënës  
dhe vinin duart mbi kokën time,  
duart me dhé e të vrara prej par mendës.

Më mbanin në krahë vajzat, shoqet e nënës,  
më puthnin gjithë ato xhixhi të forta,  
më pekulepsnin e më tregonin përralla  
plakat që në mbrëmje dilnin te porta.

Përralla pér thatësirën e shkëmbin e Dokos,  
pér egërsirat e majës së malit,  
pér magjitet që shteronin krojet e gjiret,  
ndanin burrin nga gruaja, babanë prej djalit.

Gjithmonë do t'më marrë malli pér qumështin  
që sillnin barinjtë nga mali Shendëlli,  
pér borën e çajin e majave në verë,  
pér thëllëzat që fshihen në guvat e tij.

Pér oshëtimën pranverore, kur vijnë dhentë:  
dhentë ngjiten bora zbret nga malet;  
këmborë e zile ngjiten nën ajrin e qelqtë,  
përrenjtë përplasin dallgët në zallet.

Gjithçka këtu e dua, por më shumë  
njeriun që ngjiti socializmin në shkrepat,  
oshëtima e kësaj jete del nga fshati  
ngrihet mbi male, merr radiot dhe gazetat.

Dhe ngrihet kjo e pandalshme, e pandërprerë:  
e bardhë në dimër,  
e bardhë në pranverë.

## *Natë para korrjeve*

Humbisni këtë natë me mua fushave  
nën tufën e rrezeve të hënës,  
si nën krahët e fluturave,

nën kristalet e padukshme të vesës...  
Fusha nënë e re dhe e bukur,  
nën diell do të lindë nesër.

Eci, me aroma gruri mbushur,  
ngjyrën e fytyrës në diell thekur:  
ndriçimi si i farës së re të pjekur.

Heshtja rreh t'i ngurosë sendet,  
siç fsheh të qeshurën një nuse,  
por ja, vjen puhia tingëlluse.

Qetësi, me zë të ulët me vetveten  
gjithë natën toka diç belbëzon,  
toka që nesër do të bjerë lehonë.

Humbisni dhe ju si unë grunjave,  
dëgjoni zérat e fushës së urtë...  
Ja, lindja  
si lulet e prera pikon qumësht.

## *Ku e ka folenë bilbili?*

Në gojën e foshnjës që thotë «baba»,  
në kashtën e blertë nga del kalliri,  
në kraharorin e ngrohtë të vajzave  
e ka folenë bilbili.

Te dora që shkruan *a-në* së pari,  
tek lexon vjershat që shkroi Naimi,  
në zarfin e letrës së kufitarit për nënën  
e ka folenë bilbili.

Në kapriatat e uzinës mekanike,  
mbi zhurmë frezash, mbi detale alumini,  
nën qerpikun e bukur të frezatores  
e ka folenë bilbili.


Nën drurët që rënkojnë nga stuhia,  
ku i fryn bariu fyellit prej bliri,  
ku ulen e rrinë fjollëzat e borës,  
e ka folenë bilbili.

Maja me borë ngjyrosur me diell,  
mbrëmja përreth mban erë tërfili,  
në pemën që pasqyrohet me borën në ujëra  
e ka folenë bilbili.

Në dorën me pluhur qomyri të minatorit,  
si bima me pak dhé që sapo e çel prilli,  
te ajo dorë që jep ngrohtësi e dritë,  
e ka folenë bilbili.



**BURIME TË NXEHTA**



## *N a i m i t*

Brinjët e dala  
në gjoksin e Naimit  
qenë flatrat e shqiponjës së flamurit;  
mes këtyre brinjëve rridhte gjaku ynë  
i vjetër që nga koha e gurit.

Përmes këtyre brinjëve të holla  
fare lehtë mund të shiheshin mushkëritë,  
kur thithnin diellin  
e blerimin e vargmaleve,  
kur thithnin burimet dhe kaltërsitë.

Mund të shihje si rritheshin  
të forta e të bukura

motivet që i lëviznin brenda gjirit;  
në ato brinjë  
mavia e thellë e maleve,  
në atë gjak rrezja e pritur e agimit.

Brinjët e dala e të holla  
në gjoksin e poetit  
u bënë flatra për shqiponjën e flamurit,  
me ato flatra ai udhëton drejt nesh,  
në zemrën e foshnjes e të burrit.

## *Shiu*

(peizazh)

Shiu më kujton kuajt e egër  
që endeshin dikur shpat më shpat,  
endeshin para se të vinin njerëzit  
dhe të ngrinin qytetet pak nga pak.

Kopetë e kuajve me radhë,  
kërcëllimë e thundrave një mijë  
ndoshta u bënë re e bardhë,  
nëpër shiun tek njerëzit vijnë.

Vijnë tek dritaret me trokëllimë  
kuajt e egër që s'njihnin frerëtë  
shkelin gjithçka me mall e çudi,  
lëkündin krifën e argjendtë.

Po sa kanë frikë kur ndërrohet moti  
çdo rreze dielli u ngjan si freri,  
brofja e tyre e madhërishme  
shkon shpat më shpat si hark ylberi.

## *Plakat*

Atje pranë janë shpatet plot gurë  
të përvëluara nga vera, të mbuluara nga myshku  
dhe lumthi ku gjithmonë janë përbysur  
qielli dhe blerimi i pyllit prej dushku.

Aty jetuat ju që s'ju përulen hallet, vdekjet,  
plaka gojëmbëla, punëtore si dallëndyshe;  
na rritët buzëgaz në varfërinë e pasluftës...  
Na paskeni dashur shumë, gjyshe.

Ju ikët si kodrat e qielli që përbysen në lumë,  
po unë, sigurisht, mund të ngjall te kjo letër  
lëvizjet tuaja,  
mos u qani, gjyshe, për ne jeni të gjalla.

## *Këngët verore të pyllit*

Kënga e bilbilit ngjan me gurgullimën  
e burimit të vogël në pyje;  
në heshtjen e thellë të natës  
zëri zgjatet me drurët gjer tek yjet.

Ditën vijnë njerëzit, makinat,  
dielli than ujin pa arritur në lumë  
ai humbet nëpër barin, gjethet,  
kumbon, lodhet, bie në gjumë.

Uji i mekur fshihet te bari,  
zogu i hutuar në pemët degëgjera;  
dëgjohen gjahtari e druvari,  
bariu sjell tufën me shqerra.

Presin natën verore pa zhurmë  
kënga e zogut, uji i pyllit,  
ujin freskia e çon gjer në lumë,  
kënga në heshtje i afrohet yllit.

## *M i g j e n i*

Duke ecur  
nëpër kasollen e varfér të natës,  
ai klithte: «Pak dritë, pak poezi!»  
i mbërthyer nën muret e lagjes së varfér.

Nën muret e errëta,  
nën trarët me blozë pise  
ku mbi zhgane lypsash e prostitutash  
si murgeshë e përulur nata dremiste,  
Migjeni i mshonte penës:  
«Pak dritë, pak poezi!»  
Hija e penës ngrihej në mure  
e rëndë si qysqi.

«Pak dritë, pak poezi!»  
Shkallmonte natën e kasolleve pena si qysqia,  
çeleshin baxha drite në mure e çati  
dhe dilnin vargjet e tij të lirë.

## *Pemët që s'flenë*

Në mbrëmje pemët mbi kodra,  
ngarkuar si të lashtët karvanë...  
Mos është malli i fortë  
si i ngulur në tokë,  
udhëtimi drejt nesh i atyre që duam?...

Të bëhen ato si miqtë,  
si prindërit,  
kur muzgu i fikson në statuja,  
udhëtojnë ato drejt nesh pa u ndalur  
në vapë, në erëra, në ujëra.

Mjafton t'i duash degëgjelbërat,  
si njeriun që aq shumë e pëlqen,

janë në netët e kthjellëta a të zymta  
pemët roja-malli të heshtura që s'flenë.

Mëngjeseve ato majë kodrave  
plot aromë nën një vijë të fortë drite,  
janë gjelbërimi i përjetshëm i atyre që duam,  
çelur nga ne, gjithmonë në rritje.

## *Kujtimit të gjyshit*

(motiv i shkuar)

Qengjin do ta nxjerrin në pazar...  
Sa një kokërr breshër loti i nxehtë  
shkundet nga grushti i vogël  
i bariut të mitur me thupër të blertë.

Qengji do të shitet në pazar...  
Bien lotët,  
bien nga degët e gjelbra frutat e njoma,  
bien ylberët nga kraharori i argjendtë i shirave,  
bie përtokë shikimi i nënës së bariut të vogël.

Burri i ulur në gur para shtëpisë  
dredh cigare,  
e gjatë rruga deri në pazar.

Dikur edhe ai e ka pasur lëkurën e fytyrës  
si pika e vësës,  
tani i ashpër, i parruar del ai para gruas e birit,  
para dimrit e verës.

I ka shitur qengjat një nga një,  
ka shitur qetë e plorit,  
ka shitur shumë dhe, sa herë shiste,  
thika i qenë ngulur kraharorit.

Bryma e vapa e pazareve e thinjën...  
Bariu i vogël përqafon manarin,  
ç'ka ai plak që s'e dredhka dot cigarin?

## *Deti*

Unë i takoj malit, siç janë tē tijtē  
shkëmbinjtë, gérxhet dhe krojet e tharë,  
këtu qenka deti; vij nga arat e shkrumbuara,  
ku pikë e shiut është mjaltë.

Eca sonte nëpër vijën e shkumëzuar,  
ku puthen dheu e deti;  
sytë ecnin nëpër vijën e artë tē perëndimit,  
ku ujin e pret qielli dhe deti.

Vij nga malet, ku uji nga shkëmbi del pikë-pikë,  
këtu qenka deti — ky pyll i pafund me ujë;  
kështu para meje malësorë tē tjerë  
janë gdhirë tē mrekulluar buzë detit si unë.

## *Borxhi*

U rrita me zogjtë,  
nëna barin e mbështillte në beze,  
ndërsa niste një ninullë të ngrohtë;  
si fole ishte djepi,  
mbi po atë bar rritheshin dhe zogjtë.

Gjyshi për djep preu një dru arre,  
kjo pemë solli në trupin tim  
aromën më të mirë nga fushat -  
më rriti ky dru siç rriste frutat.

Kur mbillnin më vunë në brazdën e butë  
që e hapte plugu i bardhë,  
përreth vinin harabela e turtuj;  
kjo vlagë më rriti si dhe bimët në arë.

Jam rritur me qengjat,  
gjyshi i donte si dritën, si bimët,  
shpesh më linin mua, që atyre  
t'u pushonin blegërimën.

Këto dhera e pemë  
më janë të dashura si njerëz,  
si gjyshi që vdiq,  
si prindërit që m'u zbardhën...  
Për lulëzimin pa fund të kësaj toke  
tani kam radhën.

## *Në nës*

U deshën miliona vjet që të krijohem unë.  
Njerëzit që ikën gjithçka të mirë e lanë në fytyrën  
time;  
të falem ty që më mbajte në ëndrra,  
në trupin e ngrohtë e pastaj më linde.

Ju falem syve të tu thelluar në gropat,  
ëmbëlsisë së veshur me të zeza të rënda,  
ecjes sate ku paksa ndihen epokat,  
fytyrës prej plake nga mali.

U deshën miliona vjet që të krijohem unë.  
Me mua u rrit njeriu që e deshi jetën, lirinë.  
Nëna, shihni tek unë më të mirën gjë nga ata që ikën  
që do t'ua çoj më të plotë atyre që vijnë.

Linda unë me fytyrë të vërtetë njeriu,  
i dashuruar me komunizmin, me dritë lirie,  
që do t'i sjell jetës diçka më të bukur, më të madhe  
mbi atë që erdhi gjer në lindjen time.

## *Fshati skore*

Fshat i vogël me pesëmbëdhjetë kisha,  
fshat i zhytur nën pesëmbëdhjetë hije,  
jetonte rrethuar nga pesëmbëdhjetë prita zie,  
pesëmbëdhjetë re ia zinin diellin që në lindje.

Pesëmbëdhjetë vajtime ndiheshin çdo ditë,  
pesëmbëdhjetë kuaj të zinj i bridhnin mbi të mbjella,  
pesëmbëdhjetë litani nina-nanë për fëmijët,  
pesëmbëdhjetë ujq ia shqyenin dhen e shqerra.

Fshati me pesëmbëdhjetë shenjtorë të zinj,  
çdo vit i ndriçuar nga pesëmbëdhjetë qirinj,  
viti i thërrmuar në pesëmbëdhjetë festa,  
pesëmbëdhjetë qirinj drite kur natë ishtejeta.

Fshati që pesëmbëdhjetë ditë hante bukë të grunjtë.  
e gjithë vitin hante bukën e kurbetit,  
fshati që lutej në pesëmbëdhjetë kisha  
për fëmijët jetimë me prindër tej detit.

Pesëmbëdhjetë herë në ditë vetes i bënte gjyqin,  
pesëmbëdhjetë herë në ditë vetes i vinte kryqin,  
kryqin mbi çdo kurorë e lindje,  
kryqin mbi grurë, mbi korrje e shirje.

Fshati i rrethuar nga pesëmbëdhjetë akrepa,  
që ia helmonin ditët, ia bënин shterpë;  
në këtë marramendth të tmerrshëm kapitës  
ecte së prapthi, kthyer shpinën dritës.

Sot ndrit i ngritur mbi pesëmbëdhjetë legjenda,  
pesëmbëdhjetë shtigje qel dita dhejeta;  
si bimet rrënjjeforta mbushur me fruta,  
duart e tij u ngarkuan nga drita e buka.

## *Busti i dëshmorit të fshatit*

E bukur është fytyra e tij prej njeriu,  
hijet e gjetheve të pemës luajnë mbi të,  
fëshfërijnë kallamat buzë lumit.

Gjethe të buta e ledhatuese si pushi mbi duart  
që dikur ia shtrëngonim; fëshfërima, si fjalë,  
që buzët e tij dikur, të hapura, na i drejtonin.

Gjaku i shpërthyer nga damarët që i çau predha  
zbardhoi fytyrën e luftëtarit,  
për ta kthyer përjetësisht në trupore guri.

E bukur është ideja e shndërrimit të tij në statujë,  
gjethet i fëshfërijnë mbi sytë e gurtë,  
kallamat përkulen nga era mbi lumë.

## *T r i n e t*

1.

Ushtar. Nata e parë e pranverës.

Jam għidher nën njē kumbull tē egér,

preka me duar drithërimat e saj,

kur nën gishtat e sertē tē erës,

pema shkopsiste sythat, gjinë,

para syve më çelin lulet -

flakëza tē bardha nē errësirë.

2.

Korrjet. Ora njē. Nata e verës

ka njē ngjyrë si nē tē gjelbér;

mbi barin farëpjekur me aroma  
humbas nën fëshfërimë degësh.

Zgjohem  
po ndihem bir i drejtpërdrejtë i tokës,  
vëllezërit e mi të mirë qenë me mua  
bari, lumi e lisat e kodrës.

### 3.

Ora njëzet e tre.  
Sytë të sapokëputur prej gjumit,  
në këto net qielli është më poshtë,

më afér janë yjet,  
zhurmat e pemëve e të lumit.

Hyjmë në minierë,  
këtu njeriu për njeriun është më afér,  
shoku për shokun është jetë  
nën shkëmbinj, nën net.

## *Kështjella*

Sa dal rrugeve natën apo ditën  
para meje kështjella e qytetit  
e gjallë dhe e gurtë  
nisur drejt nesh që nga të vjetrit.

Nën kubetë e saj bulëzon ujë  
e jehon mureve një pikë-pikë,  
armët e trofetë kryqëzohen mureve  
si në duart e njerëzve një kohë e një ditë.

Mbështeta kokën e lodhur mbi mur,  
me gjithë trupin peshova mbi këtë lashtësi,  
si në ëndërr te çdo gur shihja njerëz të gjallë,  
në çdo kornizë guri lëvizte një njeri:

Ja njeriu me çekan dhe me gozhdë,  
ja njeriu që tërë jetën poqi bukën,  
ja ai që rrahu hekurin në farkë  
dhe ai që me kaldrëm shtroi rrugën...

Në shekuj brezat nuk shkuan, nuk vdiqën,  
të kthyer në gur erdhën te kjo kështjellë  
sërë-sërë më lart muret e rëna ngritën,  
unë sot kokën mbi ta e kam vënë.

Ngado që shkoj rruga më sjell këtu  
te këta njerëz që s'i njoha dhe s'i pashë kurrë:  
me punët dhe me dashuritë tona  
u lidhkemi fort në një mur.

Kështu erdhi te ne kjo kështjellë,  
kanë ardhur njerëzit, kanë ardhur gurët  
me nga një emër, me nga një dritë  
e një pe i hollë uji pikë-pikë  
numëroi në shekuj çdo sekondë, çdo ditë.

## *Tavan me njëqind plumbë*

Kjo dëshmon për luftë të madhe, më thanë,  
t'i sjell të gjälla ato vite të zjarrta;  
kur u thashë se në Hllomo një tavan  
ka njëqind plumbë në dhogat e thata.

Kryeplaku barkfryrë e i vrenjtur  
e rrithoi këshillin e ri të luftës,  
të rreckosurit luftuan për idealin,  
ai luftonte për të drejtën e vulës.

Kryepleqësinë ia dhanë nga lart, nga qelli,  
ndaj tavanin qëlloi si i marrosur, i mjeri,  
s'e dinte që pushteti nuk ishte më hyjnor,  
populli e ndërtonte të ri nga themeli.

Dhe iku ai bashkë me qiellin e tij,  
iu lag baruti, iu lag përgjithmonë vula,  
për bërezat që vijnë, mbeti në Hllomo  
një tavan i çarë nga njëqind plumbë.

## *Skënderbeu*

Duke u ngjitur pér te kështjellat e tua,  
me sytë te muret që grisnin cipën e qiellit,  
kujtova të shumëvuajturit njerëzit tanë  
nga majëmalet, te dallgët e anëdetit.

Te kështjellat e tua në male  
nuk gjeta gjeneralë të lavdishëm,  
por barinj, bujq, e sharrëxhinj  
me brymë dhe erë mbi flokët e tyre,  
me ballin të çarë — qilizëm.

Njerëz nga ata që na mësuan  
draprin në të korra, armën në luftë,  
plugun në të mbjella  
dhe këngë pér ty, gojëdhëna e legjenda.

Me ata fola sot për ty, Skënderbe,  
me kështjellat e tua të papushtuara-njerëzit,  
ata të thjeshtët e të mëdhenjtë  
sa vetë heronjtë e tyre  
nga majëmalet te shkuma e bregdetit.

## PASQYRA E LËNDËS

Faqe

### YJET E NËNTOKËS

E shtunë, mesnatë .....	5
Pesha e tokës .....	7
Letër .....	9
Yjet e nëntokës .....	11
Qielli dhe qyteti .....	12
Trimëri e re .....	14
Zogjtë .....	16
Minatori dhe dielli .....	18
Zbritje në thellësi .....	19
Dallëndyshet e minierës .....	21
Njeriu i punës .....	23
Zérat e thellë .....	24
Gjithmonë e bukur .....	26
Mirëmbec, bilbil .....	28

### DITË ME EMRA TË BUKUR

Revolucioni .....	33
Ditët me emra të bukur .....	34